Biznesi i Madh dhe Institucionet, **1,482** subjekte në total, kontribuojnëme tarifën me **52,407,000** lekë në total, që përbën 17.37 % tëkostos (shpenzimeve totale të planifikuara) përfshirë ato operative dhe investimet e parashikuara në vitin 2024.

Biznesi i vogël, **4,069** subjekte ne total në qytet dhe në Njësitë Administrative, kontribuojnëme tarifën, me **53,057,000** lekë në total, që mbulon 17.74% të kostos (shpenzimeve totale të planifikuara), përfshirë ato operative dhe investimet e parashikuara në vitin 2023.


Kostoja e plotë e shërbimit mbulohet nga **195,324,000** lekë nga të ardhurat nga tarifa, ose 65.16 %, Ulja e mbulimit të kostos ka ardhur për shkak të efektit të rritjes së cmimit të depozitimit në lëndfillin e Bushatit dhe pagat e fuqisë punëtore, me rritjen e minimumit të pagave me vendim qeverie.

Biznesi	Nr. subjekteve	Te ardhurat nga tarifa e pastrimit prej biznesit, në lekë
Biznesi i Madh dhe Institucionet	1,482	52,407,000
Biznesi i vogël qytet	3,332	53,057,000




Totali i mbulimit të kostos nga tarifat (LEKË/vit)	195,324,000
Transferte specifike per mbetje urbane akorduar nga qeveria	16,123,000
Subvencionim nga Bashkia (LEKË/vit)	87,596,000

BURIMET E FINANCIMIT PËR SHËRBIMIN E GRUMBULLIMIT, TRANSPORTIMIT, DHE DEPOZITIMIT TË MBETJEVE URBANE PËR VITIN 2024



KONTRIBUTI I FAMILJEVE DHE BIZNESIT I DETAJUAR



ii. Synimi i projektit të vitit 2024-2026

- Zgjerimii shërbimit në territor;
- Përmirësimi i frekuencave të evadimit të mbetjeve;
- Përdorimi me efikasitet i burimeve financiare;
- Llogaritje më e mirë e normës së prodhimit të mbetjeve për çdo njësi, për familje dhe biznese, referuar historikut të të dhënave dhe përlogaritjeve që marrin në konsideratë vendosjen e popullsisë, dhe të bizneseve;
- Shtim i pikave të grumbullimit;

<ul style="list-style-type: none"> • Shtim i kontenierëve; • Përmirësimi i cilësisë së fshirjes së rrugëve • Zbatim i sistemit të monitorimit të shërbimit në mënyrë më të automatizuar në të gjithë territorin; • Sensibilizim i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të pastër; • Ndërtimi i platformave përvendosjen e kontenierëve për një shërbim më të mirë, dhe për me shumë siguri. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Viti 2024-2026 <ul style="list-style-type: none"> - Vijimi i shërbimit të pastrimit me sipërmarrje private. - Aplikimi i sistemit të adminstrimit dhe monitorimit i automatizuar, dhe transparent. - Marrje e masave për përgatitjen e sezonit turistik. - Investime për infrastrukturë mbështetëse për realizimin e shërbimit. - Studim dhe vlerësim i procesit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve ne: të thata dhe të njoma, në zona pilot të qytetit. - Sensibilizimi për rritjen e bashkëpunimit me komunitetin dhe ndërgjegjesimi i tyre për diferencimin e mbetjeve që në burim. - Bashkëpunimi me shkollat, institucionet dhe biznesin për rritjen e interesit për reduktimin e mbetjeve urbane dhe ndarjen e mbetjeve të riciklueshme. - Shtimi i pikave të grumbullimit - Hartimi i rregullores për marrëdhëniet mes pushtetit vendor, sipërmarrësve të shërbimit, bizneseve, institucioneve dhe familjarëve për mënyrën e trajtimit të mbetjeve urbane dhe masat administrative për kundravajtësit. - Eliminimi i mbeturinave urbane nga vendepozitimet e palejueshme me mjetet e bashkisë si dhe kryerjen e shërbimit në ato zona të pa parashikuara në sipërmarrjet private. - Vazhdimi depozitimit të mbetjeve urbane në landfillin Bushat. - Në kuadër të përmisimit të performancës së shërbimit të funksionojë sistemi i monitorimit. - Investime për infrastrukturë mbështetëse për realizimin e shërbimit. 						
b) Rezultatet që prisni						
Viti 2024-2026 Për shërbimin e pastrimit të qytetit <ul style="list-style-type: none"> • Shërbim me parametra të përmirësuar për të gjithë territorin. • Shtimi i pikave të vendeve të grumbullimit të mbeturinave dhe numrit të kazaneve për ti shërbyer më mire familjareve dhe bizneseve. • Studim dhe vlerësim për procesin e diferencimit të mbetjeve urbane në burim. • Ofrimi i shërbimit në orare të përcaktuara sipas një grafiku paraprak. • Interesim i biznesit për fillimin e procesit të riciklimit. • Monitorim i qëndrueshëm dhe raportim on-line nga supervizorët dhe inspektorët e lagjeve. • Përmirësim infrastrukturës mbështetëse për realizimin e shërbimit. • Depozitimi i të gjitha mbetjeve urbane në landfillin Bushat dhe reduktimi i vend depozitimeve të pamiratuara. • Përmirësim i kënaqësisë së qytetarëve për shërbimin e ofruar. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme		
Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit Subjektet që operojnë për të realizuar shërbimin e pastrimit të qytetit Monitoruesit në të gjitha lagjet e qytetit të Bashkisë Shkodër Komuniteti dhe Bizneset Banorët e qytetit të Shkodrës				Bashkia Shkodër		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve në zonat urbane						
A1 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve në zona urbane për Bashkinë Shkodër zona Qytet (kontrata me afat 01.01.2024-30.04.2024)	28,651			28,651		
A2 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve në zona urbane për Bashkinë Shkodër zona Qytet (kontrata me afat 01.05.2024-31.12.2024)	71,349			71,349		
B Investime						
B1 Blerje kazanësh	3,000					3,000
TOTALI	103,000			100,000		3,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale

A. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve në zonat urbane						
A1 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve në zonat urbane për Bashkinë Shkodër zona Qëndrore	100,000			100,000		
B Investime						
B1 Blerje kazanësh	3,000					3,000
TOTALI	103,000			100,000		3,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve në zonat urbane						
A1 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve në zonat urbane për Bashkinë Shkodër zona Qëndrore	100,000			100,000		
B Investime						
B1 Blerje kazanësh	3,000					3,000
TOTALI	103,000			100,000		3,000
f) Periudha e zbatimit Janar 2024 deri me 31 Dhjetor 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit Institucioni likuidues: Ndermarrja e shërbimeve dhe puneve publike				

Nr.4	P05100.Q1.O3.A1 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve	Funksioni 5: Mbrojtja e mjedisit N/Funksioni 051: Menaxhimi i mbetjeve Llojet e programit: 05100:Menaxhimi i mbetjeve																																				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit																																						
i. Situata																																						
<p>Bashkia Shkodër ka bërë të mundur administrimin dhe menaxhimin e shërbimit të pastrimit në qytetin e Shkodrës dhe në 8 njësi administrative, përfshirë këtu edhe qytetin e Shkodrës.</p>																																						
<p>Bashkia Shkodër depoziton mbetjet urbane të grumbulluar nga të treja zonat funksionale në Lendfillin e Bushatit . Për zonën qendrore sipas kontratës dy palëshe ndërsa për njësitë administrative të zonës Perëndimore dhe Lindore</p>																																						
<p>re me ane të operatorëve sipërmarrës. Bashkia Shkodër përlogarit buxhetin që l nevojitet për të treja zonat për të parën qytetin e menaxhon me anë të kontratës të drejt për drejtë me lednfillin ndërsa me dy zonat e tjera buxheti parashikohet në buxhetin vjetor duke e reflektuar në kontratat respective me operatorët sipërmarrës të zonës Lindore dhe Perëndimore.</p>																																						
<p>Bashkia Shkodër me datën 24.10.2023 ka marrë njoftim zyrtar për vendimarrjen e Asamblesë së Përgjithshme të aksionerëve të Shoqërisë Ndërkomunale Bushat sha për rritjen e cmimit për shërbimin e depozitimit të mbetjeve urbane në vendgrumbullimin e mbetjeve në lendfilline Bushatit me 1695 lekë pa tvsh,vendim me Nr.14 datë 16.10.2023. Vlera e shërbimit për depozitimin për të treja zonat do të duhet të reflektohet në buxhetin e vitit pasardhës dhe të tre viteve të buxhetit afat mesëm 2024-2026.</p>																																						
<p>Mqs Gjykata administrative e Apelit në Tiranë hodhi poshtë kërkesë padinë e Bashkisë Shkodër për lendfillin e Bushatit, kontratat respective do ta pasqyrojnë cmimin e rritur sit ë plotë së bashku me vendimarrjen e fundit nga Asambleja e Përgjithshme e Ndërkomunale Bushatit, me anë të amendamenteve të kontratës për zonat Lindore dhe Perëndimore dhe me anë të kontratës respective për zonë Qendrore.</p>																																						
<p>Si më poshtë paraqitet parashikimi për vitin 2024 dhe atë afatmesëm.</p>																																						
Vlera e depozitimit të mbetjeve																																						
<table border="1"> <thead> <tr> <th>Zonat Funksionale</th> <th>Tonazhi /ton</th> <th>Leke/pa tvsh</th> <th>TOTALI /pa tvsh</th> <th>Totali me tvsh</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Qyteti</td> <td>28,888.00</td> <td>1,695.00</td> <td>48,965,160.00</td> <td>58,758,192</td> </tr> <tr> <td>Lindore</td> <td>5,545.00</td> <td>1,695.00</td> <td>9,398,775.00</td> <td>11,278,530</td> </tr> <tr> <td>Perendimore</td> <td>4,946</td> <td>1,695.00</td> <td>8,383,470.00</td> <td>10,060,164</td> </tr> <tr> <td>TOTALI</td> <td>38,799.00</td> <td>1,695.00</td> <td>66,747,405</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>TVSH</td> <td>13,349,481</td> <td rowspan="2">80,096,886</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>Total me TVSH</td> <td>80,096,886</td> </tr> </tbody> </table>	Zonat Funksionale	Tonazhi /ton	Leke/pa tvsh	TOTALI /pa tvsh	Totali me tvsh	Qyteti	28,888.00	1,695.00	48,965,160.00	58,758,192	Lindore	5,545.00	1,695.00	9,398,775.00	11,278,530	Perendimore	4,946	1,695.00	8,383,470.00	10,060,164	TOTALI	38,799.00	1,695.00	66,747,405				TVSH	13,349,481	80,096,886			Total me TVSH	80,096,886				
Zonat Funksionale	Tonazhi /ton	Leke/pa tvsh	TOTALI /pa tvsh	Totali me tvsh																																		
Qyteti	28,888.00	1,695.00	48,965,160.00	58,758,192																																		
Lindore	5,545.00	1,695.00	9,398,775.00	11,278,530																																		
Perendimore	4,946	1,695.00	8,383,470.00	10,060,164																																		
TOTALI	38,799.00	1,695.00	66,747,405																																			
		TVSH	13,349,481	80,096,886																																		
		Total me TVSH	80,096,886																																			
ii. Synimi i projektit të vitit 2024-2026																																						
<ul style="list-style-type: none"> • Zgjerimii shërbimit në territor; • Përmirësimi i frekuencave të evadimit të mbetjeve; • Përdorimi me eficiencë i burimeve financiare; • Llogaritje më e mirë e normës së prodhimit të mbetjeve për çdo njësi, për familje dhe biznese, referuar historikut të të dhënave dhe përlogaritjeve që marrin në konsideratë vendosjen e popullsisë, dhe tëbizneseve; • Zbatim i sistemit të monitorimit të shërbimit në mënyrë më të automatizuar në të gjithë territorin; • Sensibilizim i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të pastër; 																																						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit																																						
Viti 2024-2026																																						

<ul style="list-style-type: none"> - Vijimi i shërbimit të dorëzimit të mbetjeve urbane në lëndfilline Bushatit; - Ndërmarrjen e iniciativave për zvogëlimin e volumeve të mbetjeve që dorëzohen në lëndfilline Bushatit; - Studim dhe vlerësim i procesit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve ne: të thata dhe të njoma, në zona pilot të qytetit. - Sensibilizimi për rritjen e bashkëpunimit me komunitetin dhe ndërgjegjesimi i tyre për diferencimin e mbetjeve që në burim. - Bashkëpunimi me shkollat, institucionet dhe biznesin për rritjen e interesit për reduktimin e mbetjeve urbane dhe ndarjen e mbetjeve të riciklueshme. - Zbatimi i rregullores për marrëdhëniet mes pushtetit vendor, sipërmarrësve të shërbimit, bizneseve, institucioneve dhe familjarëve për mënyrën e trajtimit të mbetjeve urbane dhe masat administrative për kundravajtësit. - Në kuadër të përmisimit të performancës së shërbimit të funksionojë sistemi i monitorimit. 						
b) Rezultatet që prisni						
Viti 2024-2026						
Për shërbimin e pastrimit të qytetit dhe në njësi administrative						
<ul style="list-style-type: none"> • Shërbim me parametra të përmirësuar për të gjithë territorin. • Shtimi i pikave të vendeve të grumbullimit të mbeturinave dhe numrit të kazaneve për ti shërbyer më mire familjareve dhe bizneseve. • Studim dhe vlerësim për procesin e diferencimit të mbetjeve urbane në burim. • Ofrimi i shërbimit në orare të përcaktuara sipas një grafiku paraprak. • Interesimi i biznesit për fillimin e procesit të riciklimit. • Monitorim i qëndrueshëm dhe raportim on-line nga supervizorët dhe inspektorët e lagjeve. • Përmirësim infrastrukturës mbështetëse për realizimin e shërbimit. • Depozitimi i të gjitha mbetjeve urbane në lëndfillin Bushat dhe reduktimi i vend depozitimeve të pamiratuara. • Përmirësim i kënaqësisë së qytetarëve për shërbimin e ofruar. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme		
Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit Subjektet që operojnë për të realizuar shërbimin e pastrimit për qytetin dhe njësit administrative Monitoruesit në të gjitha lagjet e qytetit dhe njësit administrative të Bashkisë Shkodër Komuniteti dhe Bizneset Banorët e qytetit të Shkodrës				Bashkia Shkodër		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ	Tranfer
A. Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve						
A1 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Qëndrore.		58,758		58,758		
A2 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Perëndimore.		8,902		8,902		
A2.1 Diference Shtese II Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Perëndimore.		1,158		1,158		
A.3. Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Lindore.		9,982		9,982		
A3.1 Diference Shtese II Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Lindore.		1,297		1,297		
TOTALI		80,097		80,097		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025			Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ	Tranfer
A. Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve						
A.1 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Qëndrore.		58,758		58,758		
A2 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Perëndimore.		8,902		8,902		
A2.1 Diference Shtese II Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Perëndimore.		1,158		1,158		
A.3. Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Lindore.		9,982		9,982		
A3.1 Diference Shtese II Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Lindore.		1,297		1,297		
TOTALI		80,097		80,097		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026			Nga kjo:			

		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A. Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve						
A1 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Qëndrore.	58,758			58,758		
A.2 Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Perëndimore.	8,902			8,902		
A2.1 Diference Shtese II Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Perëndimore.	1,158			1,158		
A.3. Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Lindore.	9,982			9,982		
A3.1 Diference Shtese II Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve për Bashkinë Shkodër zonat Lindore.	1,297			1,297		
TOTALI	80,097			80,097		
f) Periudha e zbatimit Janar 2024 deri me 31 Dhjetor 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit Institucioni likuidues: Ndermarrja e shërbimeve dhe puneve publike				

Nr.5	P05100.Q1.O4.A1-A2 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale	Funksioni 5: Mbrojtja e mjedisit N/Funksioni 051: Menaxhimi i mbetjeve Llojet e programit: 05100:Menaxhimi i mbetjeve															
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit																	
i. Situata																	
<p>Bashkia Shkodër ka bërë të mundur administrimin dhe menaxhimin e shërbimit të pastrimit në 8 njësi administrative të Bashkisë Shkodëre.</p>																	
<p>I.Rezultate në përmirësimin e zbatimit të ligjit përmes instrumenteve inovatorë:</p>																	
<p>A. Bashkia Shkodër ka pasur një plan të miratuar nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë i Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane për periudhën 2017-2022. Bashkia Shkodër ka miratuar Rregulloren për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta urbane me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.35 datë 26.10.2023.</p> <p>B. Drejtoria e shërbimeve publike ka të miratuar Procedurën standarde të administrimit të ofrimit të shërbimit të pastrimit për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, e cila funksionon si rregullore e brendshme e strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin e shërbimit të pastrimit për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.</p> <p>C. Bashkia Shkodër, për përcaktimin e Kostos të menaxhimit të mbetjeve dhe shërbimit të pastrimit zbaton VKM 319/2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve". Kjo ka ndikuar në përmbushjen e synimit të rritjes së performancës dhe standartit të shërbimit, përmes përmirësimit teknologjik, rritjes së frekuencave të shërbimit dhe sistemit të monitorimit dhe vendosjes së penaliteteve në kontratat e shërbimit.</p>																	
<p>II. Përshkrim i shkurtër i shërbimit që ofrohet në vitin 2024</p>																	
<table border="1"> <thead> <tr> <th>Shërbimi/ Zona</th> <th>Perëndimore</th> <th>Lindore</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Afati kontraktual</td> <td>28.06.2026</td> <td>18.10.2026</td> </tr> <tr> <td>Burimet njerëzore</td> <td>40 punonjës, 10 përgjatë gjithë vitit e 30 punonjës sezonal,</td> <td>13 punonjës</td> </tr> <tr> <td>Mjetet</td> <td>2 mjete nga 10 ton përgjatë gjithë vitit dhe një 1 mjet 10 ton e 1 mjet 5 ton rezerve.</td> <td>2 mjete 10 ton, 1 mjet 7 ton dhe 1 mjet 10 ton rezervë.</td> </tr> <tr> <td>Frekuenca e pastrimit</td> <td>Dy herë në javë, përgjatë sezonit turistik, në Velipoje-Plazh është dy herë në ditë.</td> <td>Tre herë në javë, Zona Theth dy herë në javë.</td> </tr> </tbody> </table>			Shërbimi/ Zona	Perëndimore	Lindore	Afati kontraktual	28.06.2026	18.10.2026	Burimet njerëzore	40 punonjës, 10 përgjatë gjithë vitit e 30 punonjës sezonal,	13 punonjës	Mjetet	2 mjete nga 10 ton përgjatë gjithë vitit dhe një 1 mjet 10 ton e 1 mjet 5 ton rezerve.	2 mjete 10 ton, 1 mjet 7 ton dhe 1 mjet 10 ton rezervë.	Frekuenca e pastrimit	Dy herë në javë, përgjatë sezonit turistik, në Velipoje-Plazh është dy herë në ditë.	Tre herë në javë, Zona Theth dy herë në javë.
Shërbimi/ Zona	Perëndimore	Lindore															
Afati kontraktual	28.06.2026	18.10.2026															
Burimet njerëzore	40 punonjës, 10 përgjatë gjithë vitit e 30 punonjës sezonal,	13 punonjës															
Mjetet	2 mjete nga 10 ton përgjatë gjithë vitit dhe një 1 mjet 10 ton e 1 mjet 5 ton rezerve.	2 mjete 10 ton, 1 mjet 7 ton dhe 1 mjet 10 ton rezervë.															
Frekuenca e pastrimit	Dy herë në javë, përgjatë sezonit turistik, në Velipoje-Plazh është dy herë në ditë.	Tre herë në javë, Zona Theth dy herë në javë.															
<p>B. Mbledhja dhe transporti i mbetjeve nga zonat rurale përfshin shërbimin e pastrimit në dy zonat funksionale në Zonën perëndimore me nj.a Bërdicë Ana e Malit Dajc dhe Velipojë dhe zona Lindore me nj.a Rrethina Postribë Shalë dhe Gur i Zi.</p>																	
<p>Shërbimi përfshin:</p>																	
<ul style="list-style-type: none"> Grumbullim dhe transportin e mbetjeve bashkiake në të gjithë territorin e njësive administrative të këtyre zonave funksionale zonës Perëndimore dhe Lindore ; 																	
<p>Frekuenca e ofrimit të shërbimit janë si më poshtë:</p>																	
<p>Grafik Shërbimi Pastrimit Zona Lindore</p>																	

Orari I Shërbimit 06:00-12:00

Frekuenca	2 Mjete 10 ton + 1 mjet 7 ton							1 turn/ditë/mjet
Zona Lindore	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E dielë	
Nj.A.	NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Hot – Hot i Ri – Guci – Guci e Re	NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Shtoj – Shtoj i Ri – Grude – Golem - Dobrac	NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Hot – Hot i Ri – Guci – Guci e Re	NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Shtoj – Shtoj i Ri – Grude – Golem - Dobrac	NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Hot – Hot i Ri – Guci – Guci e Re	NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Shtoj – Shtoj i Ri – Grude – Golem - Dobrac	NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Shtoj – Shtoj i Ri – Grude – Golem - Dobrac	NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Shtoj – Shtoj i Ri – Grude – Golem - Dobrac
	NjA Gur i Zi	NjA Postribe + Bardhaj	NjA Gur i Zi	NjA Postribe + Bardhaj	NjA Gur i Zi	NjA Postribe + Bardhaj	Sipas nevojës	
	<i>fshatrat turistike të nj.a Shalë</i>				<i>fshatrat turistike të nj.a Shalë</i>			

A. **Shërbimi i pastrimit Zona perëndimore:** në këtë zonë përfshihen njësitë Ana Malit, Bërdicë, Velipojë, Dajç. Në tabelën më poshtë propozohet një kalendar i mundshëm në lidhje me ditët e ofrimit të shërbimit në secilën nga njësitë vendore:

Frekuenca	2 Mjete 10 ton						1 turn/ditë
	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E dielë
Zona perëndimore	Ana Malit	Velipojë	pushim	Ana Malit	Velipojë	pushim	pushim
Nj.A.	Bërdicë	Dajç		Bërdicë	Dajç		

ÇFARË SYNOJMË NË VITIN 2024

Duke marrë në konsideratë kërkesat për përmirësimin e shërbimit të grumbullimit, transportimit dhe depozitimit të mbetjeve në landfill, janë parashikuar kostot optimale që marrin në konsideratë:

- Zgjerimin e shërbimit në territor;
- Përmirësimi i frekuencave të evadimit të mbetjeve;
- Përdorimin me efikasitet të burimeve financiare;
- Llogaritje më e mirë e normës së prodhimit të mbetjeve për çdo njësi, për familje dhe biznese, referuar historikut të të dhënave dhe përllogaritjeve që marrin në konsideratë vendosjen e popullsisë, dhe të bizneseve;
- Shtim i pikave të grumbullimit;
- Shtim i kontenierëve;
- Përmirësimi i cilësisë së fshirjes së rrugëve
- Zbatim i sistemit të monitorimit të shërbimit në mënyrë më të automatizuar në të gjithë territorin;
- Sensibilizimi i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të pastër;
- Ndërtimi i platformave përvendosjen e kontenierëve për një shërbim më të mirë, dhe për me shumë siguri.

Për realizimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane janë llogaritur kostot e shërbimit për numrin e pikave të grumbullimit, numër kontenierësh, numër dhe lloji i mjeteve dhe transporti në landfill, sipas normës së gjenerimit të mbetjeve dhe frekuencës së shërbimit. Kostoja e shërbimit që do të realizohet është si më poshtë.

Nr	Analizë	Lloji i Shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi	V
1	A	Zona 1 (Nj.a Rrethina, Postribe, Gur i Zi)				
2	VKM	Grumbullimi dhe transporti i Mbetjeve Urbane.	Ton	5,286.00		

3	VKM	Menaxhim dhe mirembajtje e konteniereve	copë	220		
4	VKB	Depozitim i mbetjeve urbane ne landfillin e Bushatit	Ton	5,286.00		
5	VKB	Diference shtese e rritjes te tarifes te depozitimit te mbetjeve ne landfillin e Bushatit.	Ton	5,286.00		
6	An-1	Dezinfektim i PGM've	Kg	2,050.00		
7		Shuma A pa TVSH				24,913,212.00
8	B	Zona 2 (Nj.a Shalë)				
9	VKM	Grumbullimi dhe transporti i Mbetjeve Urbane.	Ton	259.00		
10	VKM	Menaxhim dhe mirembajtje e konteniereve	copë	57		
11	VKB	Depozitim i mbetjeve urbane ne landfillin e Bushatit	Ton	259.00		
12	VKB	Diference shtese e rritjes te tarifes te depozitimit te mbetjeve ne landfillin e Bushatit.	Ton	259.00		
13	An-1	Dezinfektim I PGM've	Kg	418.00		
14		Shuma B pa TVSH				3,315,214.00
15	D	Procese te tjera ne sherbim te pastrimit.				
16	An-2	Mirembajtja e PGM've në Nj.a Shalë (një punëtor) për 8 muaj (240 ditë)	PGM	5,520		
17		ShumaD pa TVSH				889,040.00
18		TOTALI PA TVSH 12 MUAJ	lekë			29,067,466.00
19		TOTALI ME TVSH 12 MUAJ	lekë			34,880,959.20
20		TOTALI PA TVSH 36 MUAJ	lekë			87,202,398.00
21		TOTALI ME TVSH 36 MUAJ	lekë			104,642,877.60

Objekti: Sherbimi I Pastrimit Bashkia Shkodër Zona Perëndimore

OBJEKTI : SHËRBIMI I PASTRIMIT ZONA PERËNDIMORE / 1 Vit

NR	Analizë	Lloji i Sherbimit	Njësia	Sasia	Çmimi	
1	A	Zona 1				
2	VKM	Grumbullimi dhe transporti i Mbetjeve Urbane.	Ton	3,090		
3	VKM	Menaxhim dhe mirembajtje e konteniereve	copë	359		
4	VKB	Depozitim I mbetjeve urbane ne landfillin e Bushatit	Ton	3,090		
5	VKB	Diference shtese e rritjes te depozitimit te mbetjeve ne landfillin e Bushatit.	Ton	3,090		
6	An-1	Dezinfektim i PGM've	Kg	2,415		
7		Shuma A pa TVSH				18
8	B	Zona 2				
9	VKM	Grumbullimi dhe transporti i Mbetjeve Urbane.	Ton	932		
10	VKM	Menaxhim dhe mirembajtje kazanesh	copë	125		
11	VKB	Depozitim I mbetjeve urbane ne landfillin e Bushatit	Ton	932		
12	VKB	Diference shtese e rritjes te depozitimit te mbetjeve ne landfillin e Bushatit.	Ton	932		
13	An-1	Dezinfektim I PGM've	Kg	1,200		
14		Shuma B pa TVSH				5

15	C	Zona 3					
16	VKM	Grumbullimi dhe transporti i Mbetjeve Urbane.	Ton	924			
17	VKM	Blerje qese	copë	17,594			
18	VKB	Depozitim I mbetjeve urbane ne landfillin e Bushatit	Ton	924			
19	VKB	Diference shtese e rritjes te depozitimit te mbetjeve ne lendfillin e Bushatit.	Ton	924			
20		Shuma C pa TVSH					4,795,940.00
21	D	Procese te tjera ne sherbim te pastrimit.					
22	An-2	Punetore të mirmbajtjes të zonës të plazhit /rërës para fillimit të sezonit tursitik, dhe mbas mbylljes të sezonit për 21 ditë (pesë punëtorë)	ditë	21			
23	An-3	Fshirje manuale (dy punëtorë)	m2	572,000			
24	An-4	Mirembajtja e PGM've per 110 dite sezoni (pesë punëtorë)	PGM	8800			
25	An-5	Punetore mirmbajtje e zonës të rërës gjatë sezonit për 110 ditë (katër punëtorë)	dite	110			
26	An-6	Mirembajtja e 4 tualeteve publike ne zonen e plazhit Velipoje (8 punetore)	dite	110			
27		ShumaD pa TVSH					3,305,700.00
28		TOTALI PA TVSH 12 mujor	lekë				31,708,090.00
29		TVSH	lekë				6,341,618.00
30		TOTALI ME TVSH 12 mujor	lekë				38,049,708.00

ii. Synimi i projektit të vitit 2024-2026

- Zgjerimi shërbimit në territor;
- Përmirësimi i frekuencave të evadimit të mbetjeve;
- Përdorimi me efikasitet i burimeve financiare;
- Llogaritje më e mirë e normës së prodhimit të mbetjeve për çdo njësi, për familje dhe biznese, referuar historikut të të dhënave dhe përlogaritjeve që marrin në konsideratë vendosjen e popullsisë, dhe të bizneseve;
- Shtim i pikave të grumbullimit;
- Shtim i kontenerëve;
- Përmirësimi i cilësisë së fshirjes së rrugëve
- Zbatim i sistemit të monitorimit të shërbimit në mënyrë më të automatizuar në të gjithë territorin;
- Sensibilizim i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të pastër;
- Ndërtimi i platformave përvendosjen e kontenerëve për një shërbim më të mirë, dhe për me shumë siguri.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

Viti 2024-2026

- Vijimi i shërbimit të pastrimit me sipërmarrje private.
- Aplikimi i sistemit të administrimit dhe monitorimit të automatizuar, dhe transparent.
- Marrje e masave për përgatitjen e sezonit turistik.
- Investime për infrastrukturë mbështetëse për realizimin e shërbimit.
- Studim dhe vlerësim i procesit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve ne: të thata dhe të njoma, në zona pilot të qytetit.
- Sensibilizimi për rritjen e bashkëpunimit me komunitetin dhe ndërgjegjesimi i tyre për diferencimin e mbetjeve që në burim.
- Bashkëpunimi me shkollat, institucionet dhe biznesin për rritjen e interesit për reduktimin e mbetjeve urbane dhe ndarjen e mbetjeve të riciklueshme.
- Shtimi i pikave të grumbullimit
- Hartimi i rregullores për marrëdhëniet mes pushtetit vendor, sipërmarrësve të shërbimit, bizneseve, institucioneve dhe familjarëve për mënyrën e trajtimit të mbetjeve urbane dhe masat administrative për kundravajtësit.
- Eliminimi i mbeturinave urbane nga venddepozitimet e palejueshme me mjetet e bashkisë si dhe kryerjen e shërbimit në ato zona të pa parashikuara në sipërmarrjet private.
- Vazhdimi depozitimit të mbetjeve urbane ne landfillin Bushat.
- Ne kuadër të përmisimit të performancës së shërbimit të funksionojë sistemi i monitorimit.



- Investime për infrastrukturë mbështetëse për realizimin e shërbimit.						
b) Rezultatet që prisni						
Viti 2024-2026						
Për shërbimin e pastrimit të qytetit dhe në njësi administrative						
<ul style="list-style-type: none"> • Shërbim me parametra të përmiresuar për të gjithë territorin. • Shtimi i pikave të vendeve të grumbullimit të mbeturinave dhe numrit të kazaneve për ti shërbyer më mire familjareve dhe bizneseve. • Studim dhe vlerësim për procesin e diferencimit të mbetjeve urbane në burim. • Ofrimi i shërbimit ne orare tëpërcaktuara sipas një grafiku paraprak. • Interesim i biznesit per fillimin e procesit te riciklimit. • Monitorim i qëndrueshëm dhe raportim on-line nga supervizorët dhe inspektorët e lagjeve. • Përmirësim infrastrukturës mbështetëse për realizimin e shërbimit. • Depozitimi i të gjitha mbetjeve urbane në landfillin Bushat dhe reduktimi i vend depozitimeve të pamiratuara. • ërmirësim i kënaqësisë së qytetarëve për shërbimin e ofruar. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme		
Drejtoria shërbimeve dhe Monitorimit Subjektet që operojnëpër të realizuar shërbimin e pastrimit për qytetin dhe njësitministrative Monitoruesit në të gjitha lagjet e qytetit dhe njësitë administrative të Bashkisë Shkodër Komuniteti dhe Bizneset Banorët e qytetit të Shkodrës				Bashkia Shkodër		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Siguri me	Operativ	Transfer	Kapitale
A. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale						
A.1 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale, zona "Lindore"	24,900			24,900		
A.2 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale, zona Perëndimore	27,151			27,151		
B. Investime						
B.1 Ndërtim xhepash per konteniere	1,000					1,000
TOTALI	53,051			52,051		1,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ	Transfer	Kapitale
A. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale						
A.1 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale, zona "Lindore"	24,900			24,900		
A.2 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale, zona Perëndimore	27,151			27,151		
B. Investime						
B.1 Ndërtim xhepash per konteniere	1,000					1,000
TOTALI	53,051			52,051		1,000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Nga kjo:				
		Paga	Siguri me	Operativ	Transfer	Kapitale

A. Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale					
A.1 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale, zona "Lindore"	24,900			24,900	
A.2 Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat rurale, zona Perëndimore	27,151			27,151	
B. Investime					
B.1 Ndërtim xheshash per konteniere	1,000				1,000
TOTALI	53,051			52,051	1,000
f) Periudha e zbatimit Janar 2024 deri me 31 Dhjetor 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja shërbimeve dhe Monitorimit Institucioni likuidues: Ndermarrja e shërbimeve dhe puneve publike			

Nr.6	P05100.Q1.O5.A1 Pastrimi i rrugëve dhe i parqeve	Funksioni 5: Mbrojtja e mjedisit N/Funksioni 051: Menaxhimi i mbetjeve Llojet e programit: 05100: Menaxhimi i mbetjeve
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
i. Situata		
<p>Bashkia Shkodër me realizimin e shërbimit të pastrimit me kontratat sipërmarrëse realizon edhe pastrimin errugëve manulaisht dhe me mjet teknologjik përfshirë ketu rrugë dhe sheshe dhe trotuarë ku është e lejuar . Këto shërbime realizohen me kontratën sipërmarrëse me qytetin Bashkia Shkodër qendër dhe me plazhin e Velipojës gjatë sezonit turistik për fshirje të sheshit qendror dhe pedonale apo mirmbajtjen e tualeteve publikë.</p> <p>1.1 Shërbimi i pastrimit të rrugëve dhe shesheve</p> <p><i>1.1.1 Shërbimi i pastrimit me krahë</i></p> <p>Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> Fshirjen me punëtorë me fshesë të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore, të kategorive I, II, duke mbuluar sipërfaqen e plotë të trotuarit dhe një sipërfaqe rruge 2 m nga kuneta, në gjithë gjatësinë lineare të saj. Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknologjike, (si psh. poshtë makinave apo kur ka pengesa të tjera) Operatori i Shërbimit duhet të pastrojë me punëtorë. Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike. Pas fshirjes me makineri teknologjike, punëtorët e pastrimit (fshirjes) pastrojnë çdo lloj mbeturine që ka mbetur nga procesi teknologjik i fshirjes, në mënyrë që rrugët të jenë plotësisht të pastra. Edhe ky shërbim manual pastrimi përfshihet në procesin e fshirjes si dhe në çmimin për njësi të saj. Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugorë brenda zonës së kontraktuar. Për këtë operojnë punëtorë dhe makina të veçanta. Shërbimi i zbrazjes dhe pastrimit të ambientit rreth tyre bëhet gjatë natës. Procesit të fshirjes dhe pastrimit i nënshtrohen të gjitha rrugët dhe trotuaret e parashikuara në zonën e kontraktuar (të asfaltuara, me kalldrëm si dhe trotuaret e qytetit). <p>Plani i punës dhe grafikët e punimeve janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-04.00. Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara Autoriteti kontraktor mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëres palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit. Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në destinacione apo dhe në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre. <p>Rregulla për t'u zbatuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e Kontraktorit. Kontraktori detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit. Për raste të veçanta Kontraktori është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime. Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie, Kontraktori detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerrin gjoba për mosplotësim të tyre. 		



Kontraktori duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimet Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
- Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë.
- Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur me uniforme.

1.1.2 Shërbimi i pastrimit të rrugëve me makineri teknologjike

Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe gjatësitë lineare për të gjithë zonën e kontraktuar, sipas grafikeve perkates me frekuencat e përcaktuara. Operatori i shërbimit do të fshijë me makineri teknologjike fshesë për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara në zonën që do të kontraktohet. në një sipërfaqe prej 255,729 m² /ditë me frekuence 4 herë në javë. Këto janë parashikuar në grafikun e listën së rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën Qender dhe sipas hartës bashkëngjitur në kontratën e shërbimit.

Shërbimi i fshirjes së rrugëve me makineri konsiston në:

- Fshirjen me makina teknologjike fshesë të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve, duke mbuluar gjithë gjatësinë lineare të lirë sipas grafikut të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.
- Fshirjen e trotuareve dhe pedonaleve me makineri të vogël teknologjike, sipas grafikut të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Plani i punës dhe grafikët e punimeve janë si më poshtë:

- Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora **21.00-04.00**.
- Fshirja me makineri teknologjike do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 7.00 zona të jetë krejtësisht e pastër. Fshirja e trotuareve dhe pedonaleve me mjetin e vogël teknologjik, do të bëhet në oraret e dakortësuara me Autoritetin kontraktor.
- Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Kontraktori nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standardeve të kërkuara, përdorimin e makinave teknologjike, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

Rregulla për t'u zbatuar:

- Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë apo trotuare të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji. Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 2 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e Kontraktorit.
- Nuk lejohet fshirja e rrugës me makineri teknologjike, kur kjo e fundit gjatë procesit të punës operon me shpejtësi më të madhe se 6 km /orë.
- Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, shoferëve dhe pajisjeve për fshirjen e rrugëve.
- Për raste të veçanta Kontraktuesi është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.
- Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes së rrugëve, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

ii. Synimi i projektit të vitit 2024-2026

- Zgjerimii shërbimit në territor;
- Përdorimi me efikasitet i burimeve financiare;
- Përmirësimi i cilësisë së fshirjes së rrugëve
